



TrafikuUrban
PRISHTINË



Thirrje publike për marrje të letrës për riciklim nga Trafiku Urban

PËR: TË GJITHA KOMPANITË E INTERESUARA
NGA: N.P.K. "TRAFIKU URBAN "SH.A
DATA: 07.08.2019

Të nderuara kompani,

N.P.K. "TRAFIKU URBAN "SH.A ofron sasinë e letrës së grumbulluar për kompanitë e interesuara. Qëllimi është riciklimi i letrës që gjenerojmë në Objektin e N.P.K. "TRAFIKU URBAN "SH.A.

Në rastin tuaj, ju do të merrni letrën e grumbulluar në një prej kontejnerëve qendror të ndërmarrjes. Materiali që ne aktualisht ofrojmë do të vazhdojë të copëtohet si zakonisht dhe do të riciklohet nga ju.

Qëllimi ynë është ta bëjmë më të lehtë riciklimin tuaj duke përmirësuar vetëdijen për riciklimin e letrës dhe njëherit të krijojmë mundësi për kursime të konsiderueshme për biznese, kjo pasi që riciklimi është i mirë për ekonominë dhe mjedisin. Krijon vende pune dhe mban burime të vlefshme jashtë deponive. Marrja e produkteve të reja nga materialet e ricikluara gjithashtu kursen energji dhe zvogëlon ndotjen.

Kompanitë e interesuara duhet të sjellin licencën për menaxhimin e mbeturinave, e lëshuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Me respekt,

Lulzim Rexhepaj
Kryeshef Ekzekutiv

N.P.K "Trafiku Urban" SH.A
Rr. Tahir Zajmi nr.43, Prishtinë
Mob: + 383 (0) 44 135 710
Email: lulzim.rexhepaj@trafikurban-pr.com
l_rexhepaj@hotmail.com

